



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 20, datë 09 .04. 2013

PËR

**“ZBATIMIN E PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PUNËSIMIT
“SKEMA E FONDIT TË GARANCISË” SI DHE MIRATIMIN E KRITEREVE DHE
PROCEDURAVE PËR PËRZGJEDHJEN E BANKËS SË NIVELIT TË DYTË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8/1/I”b” nenit 10, pika 3/III dhe nenit 32, shkronja “k” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 7, shkronja “ç” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimin publik” (i ndryshuar); vendimin e Këshillit Bashkiak nr.53, datë 24.12.2012 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2013-2015 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2013” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vënien në zbatim të Programit të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit të parashikuar në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2013 (përkatësisht në artikullin 606 – transfertat për individë) në formën e projektit “Skema e Fondit të Garancisë”.
2. Të miratojë kriteret e përzgjedhjes së bankës së nivelit të dytë, e cila do të ofrojë shërbimin financiar përkatës për realizimin e projektit sipas pikës 1 të këtij vendimi, me përmbajtje si më poshtë:

A.Kritere të përgjithshme

- a. Të jetë bankë e nivelit të dytë;
- b. Të ketë numër klientësh të biznesit të vogël jo më pak se 2,500 (për qytetin e Tiranës);
- c. Të ketë numër sportesh të biznesit të vogël jo më pak se 4 (për qytetin e Tiranës);
- d. Të krijojë mundësi për hapje sporteli të dedikuar fondit të garancisë së Bashkisë së Tiranës;
- e. Të ndikojë në zgjerimin e tregut të kredidhënies (të përfshihen në skemë bizneset që nuk janë trajtuar më parë nga bankat për mungesë kolaterali);
- f. Të shtojë numrin e bizneseve të rinj pranë regjistrimit të Bashkisë;
- g. T’i japë mundësi bizneseve të vogla të sigurojnë kredinë pranë një kompanie sigurimi;
- h. Të paraqesë afatet kohore / skemën e kreditimit;
- i. Të menaxhojë sa më mirë riskun dhe të trajtojë mospagesat sipas specifikave që paraqet biznesi.
- j. Të paraqesë raporte javore për ecurinë.

B.Kritere të veçanta

- a. Komision zero (0) për shlyerjen e kredisë para afatit;
 - b. Norma e interesit më e ulët se tregu ekzistues;
 - c. Mbulimi i kolateralit nga ana e Bashkisë të jetë në nivelet 30 – 50%.
 - d. Norma interesi të depozitës me nivel më të lartë;
3. Të miratojë procedurat që do të ndiqen për përzgjedhjen e bankës së nivelit të dytë që do realizojë projektin sipas pikës 1, me përmbajtje si më poshtë:

A. Ngritja e komisionit të hartimit të dokumenteve

A.1 Komisioni i hartimit të dokumenteve, brenda 5 ditëve nga data e miratimit të urdhrorit të Kryetarit përgatit ftesën për ofertë, ku përcaktohet:

- a. shërbimi financiar, që kërkohet të realizohet;
- b. kriteret e përzgjedhjes së bankës;
- c. afati dhe vendi i paraqitjes së ofertës.

B. Publikimi

B.1 Përmbajtja e publikimit:

- a. shërbimin financiar, që kërkohet të realizohet;
- b. kriteret e përzgjedhjes së këtij shërbimi;
- c. afati dhe vendi i paraqitjes së ofertës;

B.2 Mjetet dhe afatet e publikimit

- a. Njoftimi për konkurim publikohet për një periudhë 10 (dhjetë) ditore në standat pranë Bashkisë së Tiranës dhe faqen zyrtare të saj, [ëëë.tirana.gov.al](http://eëë.tirana.gov.al), rubrika njoftime/publikime;
- b. Njoftimi për konkurim publikohet tre ditë rradhazi në dy gazetatat me tirazh më të madh me shtrirje kombëtare.

C. Konfidencialiteti

C.1.Konkurrimi zhvillohet sipas një procedure konfidencialiteti (sekretimi) të dokumentacionit, e cila duhet të garantojë fshehtësinë e identitetit të pjesëmarrësve dhe dokumentacionit të konkursit.

D. Ngritja e komisionit të vlerësimit të ofertave.

D.1 Komisioni i vlerësimit të ofertave në përzgjedhjen e ofertave bazohet në parimet e mëposhtëme:

- a. mosdiskriminim;
- b. trajtim i barabartë i ofertuesve;
- c. transparencë.

D.2 Numri minimal i konkurentëve

Komisioni i vlerësimit të ofertave zhvillon procedurën e shqyrtimit të ofertave vetëm në rast se janë regjistruar rregullisht jo më pak se tre konkurentë.

D.3 Komisioni i vlerësimit të ofertave, brenda 5 ditëve nga data e fundit për paraqitjen e ofertave shqyrton dokumentacionin e depozituar nga bankat konkurrese dhe përgatit propozimin për Kryetarin e Bashkisë duke listuar tre ofertat me pikët më të larta bazuar në kriteret e përzgjedhjes sipas pikës 1 të këtij vendimi.

- E. Kryetari i Bashkisë, mbi bazën e propozimit të përgatitur nga komisioni i vlerësimit të ofertave, përzgjedh bankën fituese.
 - Ë. Banka fituese publikohet në stendat pranë Bashkisë së Tiranës/faqen zyrtare të saj, rubrika njoftime/publikime, si dhe në dy gazetat me tirazh më të madh sipas afateve dhe modaliteteve të përcaktuara në pikën 3, shkronja B.2/a dhe b si dhe njoftohet zyrtarisht banka fituese.
 - F. Subjektet pretenduese ndaj procedurës së zhvilluar i paraqesin ankesë, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e publikimit të bankës fituese, Kryetarit të Bashkisë. Kryetari shqyrton ankesën dhe del me vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së ankesës dhe është përfundimtar.
4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit dhe Drejtoria e Prokurimeve, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI